

USHQYES KRISTALOR ME PERMBAJTJE TË LARTË
NPK ME MIKROELEMENTE TE ÇELATUAR ME EDTA



5 POUNDS
2.27 KG



60



AZOT TOTAL(N)	20.0%	Bakër(Cu)	0.05%
NO3: 6.0% NH4: 5.2%		Hekur(Fe)	0.10%
Ureik	8.8%	Mangan(Mn)	0.05%
FOSFOR(P2O5)	20.0%	Molybden(Mo)	0.0005%
POTAS(K2O)	20.0%	Zink(Zn)	0.05%
Magnez(Mg)	0.0251%	Bor(B)	0.02%

PRODHUAR & PAKETUAR NË
SHTETET E BASHKUARA TË
AMERIKËS NGA

MILLER CHEMICAL & FERTILIZER, LLC

HANOVER, PENNSYLVANIA
17331 U.S.A.

“EC FERTILIZER”

Makronutrientet (NPK) te derivuar nga Urea, Potassium Nitrate, Ammonium Phosphate, Sulfate Ammonia, Potassium Phosphate. **Mikronutrientet:** Magnezium, Baker, Hekur, Manganez dhe Zink jane teresish te çelatur me EDTA (Disodium Ethylenediamine Tetra Acetate Chelate). Bori i derivuar nga Sodium Borate, Molybdeni nga Ammonium Molybdate.

NUTRI LEAF 20-20-20® eshte nje ushqyes gjethor me perqendrim te larte dhe te balancuar te makronutrientve NPK. Perdoret ne programet e ushqimit ne te gjitha kulturat duke filluar nga faza e hereshme e rritjes vegetative duke ndikuar dukeshem ne gjallerimin e bimes dhe nxitjen e prodhimit.

DOZAT E PERGJITHESHME TE PËRDORIMIT: Ne ushqimin gjethor per te plotesuar programin normal te ushqimit rrenjor perdoret 200-400 gr/100 lit. uje. Ne rastet e trajtimeve zonale me pompe shpine perdoret 3 gr/lit. uje. Shtohet NU-FILM per te siguruar uniformitet dhe ngjiteshmeri te solucionit sperkates. **Ne ushqimin rrenjor** me ujitje me pika perdoret 2-4 kg / dynym. **KOHA, NUMRI I TRAJTIMEVE DHE SHPESHTIA E TYRE :** Ne pergjithesi rekomandohen 4-5 trajtime per sezon ne intervalin 7-10 dite duke filluar nga rritja e vrulleshme e bimesise. Numri dhe shpeshsia e trajtimeve eshte ne vartesi te nevojave per NPK, te kushteve klimatike dhe streseve te ndryshme (lageshtia e tepert apo mungesa e saje ne toke, temperaturat e larta, rreshjet e dendura dhe probleme fitopatologjike) te cilat mund te zvogelojne aftesine e sistemit rrenjor ne thithjen e lendeve ushqyese. **KUJDES:** Mos perdorni **NUTRI LEAF 20-20-20®** ne fund te sezonit pasi mund te vonohet ngjitimi dhe pjekja e fruitit. Gjithashtu mos perdorni **NUTRI LEAF 20-20-20®** ne pemetore dhe perimore, ku ngjyra e fruitit dhe pjekuria jane te vonuara nga perdorimi i tepert i azotit.

PERDORIMI

NE PERIME (Domate, Spec, Kastravec, Shalqin, Pjeper, Kungull, Bizele, Fasule, Selino, Sallat, Brokoli, Laker, Lulelaker, Laker Brukseli Dhe Spinaq): **Si ushqyes gjethor** me normen 0.5-1 kg/dynym ose 200-400gr/100 lit uje. Aplikimi i pare duhet te behet 3 - 4 jave pas trapjantimit. **Me ujitje me pika** perdoret 2-4 kg/dynym. **NE FRUTIKULTURE** (Molle, Pjeska, Dardha, Kumbulla, Nektarine, Kajsi, Qersh, Agrume, Ullinj, Arra dhe Bajame): **Perdoret per ushqimin gjethor** me normen 200-400 gr/100 lit. uje ose 5-10 kg/ha (0.5-1 kg/dynym) ne vartesi te fazes bimore dhe mases vegetative. **Me ujitje me pika** perdoret 20-40 kg/ha. Aplikohet heret ne sezonin e rritjes ose sa here eshte e nevojshme per ushqim shtese te balancuar **NPK. LULESHTRYDHE:** **Si ushqim gjethor** perdoret me normen 0.5-1 kg/dynym kur sythat e pare te frutave shfaqen ne kurore. Si ushqyes rrenjor me sistemin e ujitjes me pika rekomandohet 2-4 kg/dynym. **NE VRESHTA, BORONICE, MANAFERRA DHE MJEDER:** **Si ushqyes gjethor** perdoret me normen 5-10 kg/ha ne fillim te sezonit ose sa here e shikojme se bimesia ka nevojte per ushqim suplementar NPK per fuqizimin e veshuleve dhe lastareve. **KUJDES:** Mos perdorni **NUTRI LEAF 20-20-20®** brenda 60 ditëve nga pjekja pasi ngjyra dhe pjekja e fruitit do te vonohet nga aplikimi i azotit. **NE BIMET E ARAVE** (Gru, Theker, Tersher, Sorgum, Oriz, Luledielli, Asparagus, Duhan, Soje, Kikirika, Miser i Embel dhe Miser per Kokoshka): **Si ushqyes gjethor** me normen 5-10 kg /ha. Trajtimet fillojne ne fazen e rritjes se vrulleshme per te nxitjen e mases vegetative dhe rritjen e rendimentit. **NE FORAGJERE** (Jonxh, Tërfil Dhe Graminore): **Si ushqyes gjethor** me normen 5-10 kg/ha per te stimuluar rritjen e mases vegetative. **NE FRUTRRENJORE (panxhar, patate, karrote dhe qepe):** **Perdoret si ushqyes gjethor** me doze 200-400 gram per 100 litra uje ose 0.5-1kg/dynym duke filluar 3 jave pas mbjelljes.

VEREJTJE PER PERDORIMIN : PËRPUTHSHMËRIA: **NUTRI LEAF 20-20-20®** perzihet me insekticidet dhe fungicidet te cilet jane ne perdorim te gjerë ne Perimet, Frutat, Bime arash, Lulet dhe Bime Dekorative.

KUJDES: NUK perdoret me Grupin Dinitro, Bordolezin e pregatitur ne fushe, Polisulfure, NitroKalcium ose materiale shumë alkaline. Ne perzierje me produkte te tjeat **NUTRI LEAF 20-20-20®** gjithmonë hidhet ne depoziten e sperkatjes si përbërës i fundit. Kur perdoret uje shume i ftohte, lereni perzieresin e depozites se pompes te punoje disa minuta me shume per te siguruar tretjen e plote te produktit.

SHENIM : Perdorni këtë produkt në përputhje me praktikat e mira agronomike, të cilat përfshijnë përdorimin e pajisjeve sperkates cilesore per te garantuar mbulimin uniform te gjetheve. Mos trajtoni kur temperaturat janë shumë të nxehta. Trajtimet duhet të bëhen në temperature te moderuar vone mbasdite dhe ne kushte te tjera mjedisore te zone , të cilat nga pervoja juaj garantojne efektivitetin e sperkatjes dhe rezultatin e deshiruar. **RUAJTJA DHE MAGAZINIMI :** Produkti ruhet ne ambalazhe origjinale, ne vende te fresketa dhe te thata ne temperature -5 / +50°C larg rezeve direkte te diellit. Periudha maksimale e ruajtjes ne keto konditat eshte e pa kufizuar. **MBAHENI LARG ARITJES PREJ FEMIJEVE.**

E RENDESISHME : Duke qenë se **NUTRI LEAF 20-20-20®** perdoret jashte kontrollit tonë dhe duke pasur parasysh se ky produkt permban elemente te rreziku për njerëzit, kafshët dhe bimësinë, ne nuk japim asnjë garanci, të shprehur apo të nënkuptuar, për sa i përket efekteve negative ne njerez, kafshë dhe bimësi, kur ky produkt nuk perdoret në përputhje me udhëzimet e deklaruar ne këtë etiketë.

NUTRI-LEAF 20-20-20 është markë e regjistruar
e Miller Chemical & Fertilizer, LLC

DISTRIBUTOR PER SHQIPERINE : AGROHELP SHPK
DURRES , CEL : 00355 692055 309/310

